



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK**

**BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT**

**JAVA 01 31 Dhjetor – 06 Janar 2019**

Për këtë periudhë, kanë raportuar 36 rrethe ose 100% (=36/36) e tyre

2 rrethe ose 6% (=2/36) e tyre kanë raportuar me telefon, faks, postë:  
HAS, PEQIN

34 rrethe ose 94% (=34/36) e tyre kanë raportuar me postë elektronike:

BERAT, BULQIZË, DELVINË, DEVOLL, DIBËR, DURRËS, ELBASAN, FIER, GJIROKASTËR, GRAMSH, KAVAJË, KOLONJË, KORÇË, KRUIË, KUÇOVË, KURBIN, LEZHË, LIBRAZHD, LUSHNJE, MALLAKASTËR, MAT, MIRDITË, PËRMET, POGRADEC, PUKË, SARANDË, SHKODËR, SKRAPAR, TEPELENË, TIRANË, TROPOJË, VLORE.

Pa raportim brenda afatit, asnjë rreth ose 0% (=0/36) e tyre:

**NUMRI TOTAL I RASTEVE TË SINDROMAVE TË SURVEJANCËS “ALERT” NË JAVËN 01**

	JAVA 01
DIARRE PA GJAK	1.599
DIARRE ME GJAK	0
INF. RESP. TE SIPËRME	7.212
INF. RESP. TE POSHTËME	3.574
RASH ME TEMPERATURË	24
VERDHEZA	0
HEMORRAGJI ME TEMPERATURË	0
SUSPEKT MENINGITIS	0
ETHE TË PASHPJEGUESHME	0
Numri i Njësive Raportuese	393
% e Njësive Raportuese	92% (395/427)

**Rash me temperaturë**

Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe atë epidemiolog 18 raste si më poshtë nuk janë të dyshuara për fruth dhe rubeolë por për varicelë:

Fier – 7 raste

Tiranë – 2 raste


Vlorë – 9 raste

Ndersa të dyshuar për Fruth janë 3 raste raste nga rrethi i Tiranës, 1 rast nga rrethi i Kurbinit, 1 rast nga rrethi i Kuçovës dhe 1 rast nga rrethi i Korçës (për më shumë detaje shikoni informacionin e Fruthit)


---

### Infeksione respiratore

*Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas javëve*




*Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas Grup-moshave*




Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme paraqet rënie në javën e 01 krahasuar me javën paraardhëse, java 52, edhe për arsye të nënraportimit prej festave të fundvitit.

### Diarre pa gjak

*Trendi në kohë i Diarreve pa Gjak sipas javëve*




*Shpërndarja e Diarreve pa Gjak sipas Grup-moshave*




Trendi në kohë i “Diarreve pa gjak” paraqet rënie në javën 01 krahasuar me javën paraardhëse, java 52

**Trendi i “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 45 – 01 të sezonit 2017-2018 dhe të sezonit 2018-2019. Numri i rasteve.**




Në javën e 01 të vitit 2019 vërehet një trend në rënie i numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme dhe ky numër është 4% më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.


**Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas grupmoshës në javën 01 të vitit 2019. Numri i rasteve dhe Incidenca (raste/10.000)**




**Krahasimi i aktivitetit të “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas sezoneve (javët 40 – 20) dhe Pragu Epidemik. Raste/100.000**



**Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas rretheve në javët 52 të vitit 2018 dhe 01 të vitit 2019. Incidenca (raste/10.000)**




### Trendi i “Diarreve pa Gjak” në javët 45 – 01 të sezonit 2017 -2018 dhe të sezonit 2018-2019. Numri i rasteve.



Në javën 01 të vitit 2018 vërehet një trend në ritje i numrit të rasteve të “Diarreve pa gjak” dhe ky numër është 12% më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

### Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas rretheve në javët 52 të vitit 2018 dhe 01 të vitit 2019. Incidenca (raste/10.000)



Nga komunikimi me rrethet, shumica e rasteve janë raportuar nga Urgjenca e Spitaleve dhe janë të shpërndara, pa grumbullime dhe lidhje epidemiologjike ndërmjet tyre.

Nga komunikimi me rrethet që kanë ritje të rasteve nuk janë evidentuar shpërthime epidemike.

**Nivelet e Raportimit për javën e 01 sipas rretheve, në përqindje.**

